



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Drejtoria e Emergjencës dhe e Sigurisë
Direktorijati za Emergjenciju i Bezbednost
Acil ve Güvenlik Müdürlüğü



11-211 Nr. 50425 Dt. 10/04-20



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

**Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë,
Prizren**

**Kolegji BIZNESI,
Prizren**

Nr. Prot.: 116/217

Nr. Prot.: 163/19

MEMORANDUM BASHKPUNIMI

Ky memorandum lidhet ndërmejt palëve të mëposhtme:

Kolegji BIZNESI, që është institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë, i Akredituar nga “Agjencia Kosovare e Akreditimit“, dhe i licensuar nga “Ministria e Shkencës dhe e Teknologjisë“, që ka si objective të sigurojë veprimtari arsimore dhe shkencore, kultivimin e dijes dhe shkencës, mbështetjen e shoqërisë në aspektin ekonomik dhe social, si dhe afirmimin e vlerave kombëtare dhe evropiane.

Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Prizren, institucion në komunën e Prizrenit.

Palët bien dakord të respektojnë qëllimin e këtij Memorandum Bashkpunimi si më poshtë:

Nenni 1

Qëllimi

- Ofrimi i mundësisë së studentëve të Kolegjit BIZNESI, programi “Menaxhimi i emergjencave, Teknik I Mbrojtjes nga Zjarri“, në realizimin e pjesës praktike në këtë institucion,
- Shfrytëzimin e paisjeve dhe poligonit praktik të Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpetimit në Prizren,
- Bashkpunim me zjarrfikësit profesional për realizimin e pjesës praktike të programeve trajnuese të Kolegjit BIZNESI.

Neni 2

Objekti

- Të dyja institucionet dekalrojnë se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi me qëllim të aftësimit të studentëve.

Nenti 3

Komunikimi

- Palët do të caktojnë persona kontakti që do jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm. Në raste të shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Ndryshime

- Memorandum mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të palëve

Neni 5

Afati i Memorandumit të Bashkëpunimit

- Memorandumi lidhet me një afat pesë (5) vjeçar duke filluar 08.04.2019 deri me 08.04.2024
- Memorandumi mund të vazhdohet me vullnetin e palëve për një afat tjetër të përcaktuar.
- Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga pala tjetër.
- Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa sa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

Neni 6

Hyrja në Fuqi

- Ky Memorandum Bashkupunimi hyn në fuqi menjherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje orgjinale, dy prej të cilave në Komunen e Prizrenit dhe dy të tjera në Kolegjin "BIZNESI"
- Ky Memorandum Bashkupunimi u nënshkrua sot me datë 08 Prill 2019.

PËR KOLEGJI BIZNESI

Prof. Dr. Shyqeri KABASHI

/Dekani/



Prizren 08 Prill 2019

PËR KOMUNEN E PRIZRENIT

Faruk DAKAJ

/Drejtorja e Emergjencës dhe Sigurisë/

